

Aspekte të Hartës së Parë të Shqipërisë me Toponimastikë në Gjuhën Shqipe (1902)

Xherardo Nikjari

Abstrakt: Përgjatë shekujve hartografë, historianë dhe institucione nga vende të ndryshme evropiane dhe të botës kanë botuar shumë harta dhe atlase, ku tregohet përhapja gjeografike e shqiptarëve dhe e Shqipërisë në hapësirë. Ndonëse këto harta janë një pasuri e madhe me vlerë hartografike e sidomos historike, të cilat faktojnë etninë e lashtë autoktone të shqiptarëve në Ballkan, asnjëra syresh nuk ishte në gjuhën shqipe, por në gjuhën e hartografëve të huaj që i përpunuan. Botimi i hartës së parë të trevave shqiptare me toponimastikë në gjuhën shqipe më 1902 shënon një moment të madh historik pasi themeloi fushën e hartografisë shqiptare. Ky punim merr në shqyrtim rëndësinë historike, gjeografike, gjuhësore dhe kulturore të kësaj arritjeje të padytë. Harta që fryt i një bashkëpunimi të begatë gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare midis spanjollit Don Juan Pedro de Aladro Kastrioti, i mbiquajtur nga shqiptarët Gjin Aladro Kastrioti dhe Faik bej Konicës, themeluesit edhe redaktorit të revistës rilindëse “Albania”. Punimi merr për herë të parë në analizë veçoritë hartografike dhe gjeografike të hartës së parë me toponimastikë në shqip të vitit 1902. Mes shumë të dhënave përshkrimore të kësaj vepre hartografike shquhet shtrirja e trungut etnik shqiptar në Ballkanin Perëndimor gjatë fillimviteve 1900. Për më tepër, ky punim do të përshkruajë edhe ndihmesën e pashlyeshme që dha një nga gjeografët më të shquar botërorë të asaj kohe, Élisée Reclus, në drejtimin e grupit të punës që u mor me ndërtimin e hartës së parë të Shqipërisë me toponimastikë në gjuhën shqipe.

Fjalë kyçe: Gjin Aladro Kastrioti, Faik bej Konica, Élisée Reclus, Shkodër, hartë e Shqipërisë, toponimastikë

✉ MA, Independent researcher, Tirana-Albania, xherardonikjari@gmail.com

🆔 <https://orcid.org/0009-0001-1275-4665>

📄 Balkan Studies Foundation
DOI: <http://doi.org/10.51331/A045>
Journal of Balkan Studies, 4 (2), 2024
balkanjournal.org



Received: 04.05.2024

Revision: 31.05.2024

Accepted: 01.07.2024



This work is licensed under Creative Commons Attribution-NonCommercial 4.0 International License (CC BY NC)

Abstract: Over the ages, cartographers, historians, and institutions from diverse European nations and beyond have produced numerous maps and atlases, illustrating the spatial distribution of Albanians and Albania. While these maps hold significant cartographic and historical value, showcasing the ancient authentic ethnicity of Albanians in the Balkans, none have been in Albanian but rather in the languages of foreign cartographers who compiled them. The publication of the first map of Albanian territories with Albanian toponymy in 1902 marks a pivotal historical moment, establishing Albanian cartography. This paper delves into the historical, geographical, linguistic, and cultural importance of this notable achievement. The map was the product of a fruitful collaboration during the Albanian National Awakening between Don Juan Pedro de Aladro Kastrioti, known to Albanians as Gjin Aladro Kastrioti, and Faik bey Konica, the founder and editor of the Albanian National Awakening magazine “Albania”. The paper examines the cartographic and geographical characteristics of the first map with Albanian toponymy from 1902. Noteworthy among the descriptive data of this cartographic work is the extent of the ethnic Albanian presence in the Western Balkans during the early 1900s. Additionally, this paper will detail the invaluable assistance provided by Élisée Reclus, one of the foremost geographers of the time, in guiding the working group involved in constructing the first map of Albania with Albanian toponymy.

Keywords: Gjin Aladro Kastrioti, Faik bej Konica, Élisée Reclus, Shkodër, map of Albania, toponymy

Hyrje

Viti 1902 përbën një datë të rëndësishme në historinë e hartografisë shqiptare, pasi që përkon me botimin e hartës së parë të trevave shqiptare me toponimastikë në shqip (Figura 1) (Konica, 1902: 104). Kjo arritje e vyer me vlerë jo vetëm historike, gjeografike, gjuhësore, kulturore, e cila barte edhe vlerë të çmuar në fushën didaktike, përbënte kulmin e një bashkëpunimi të gjerë midis spanjollin Don Juan Pedro de Aladro Kastrioti (1845-1914) me Faik bej Konicën (1875-1942) (Skëndi, 1967, pp.318-320) themeluesin edhe drejtuesin riosh të revistës “Albania”, e cila sipas biografit të parë të Konicës, Jup Kastrati, “ka qenë e përkohshmeja më e mirë e periudhës së Rilindjes Kombëtare dhe një nga më të mirat e historisë së shtypit periodik shqiptar” (Kastrati, 2022, pp.124). I pari, i njohur ndryshe në historiografinë shqiptare si Gjin Aladro Kastrioti ose Don Aladro (Konica, 1907, pp.74),¹ ishte një fisnik nga Andaluzia, ish-diplomat i shquar e njëherësh tregtar që zotëronte një kompani të madhe verërash në Spanjë, i cili, me idenë se rridhte nga heroi kombëtar shqiptar (në degë mëmësore) - Gjergj Kastrioti-Skënderbeu – hodhi pretendimin e tij për fronin e Shqipërisë në kapërcyell të shekullit XX (Clayer,

1 Ky është varianti i shqipëruar i emrit Juan me autor Faik Konicën. Ai e bindi aristoklatin spanjoll që të përdorte këtë variant në shtypin shqiptar. “...Kur i keshillova Aladros t’a shciperogje emerin e tij, “Juan de Aladro”-n e bera “Ghini i Aladros...”.

2012: 380; Lopez, 2002, pp.209-210). Edhe pse duhet theksuar se nuk ishte një kandidat zyrtar (Redaksia, 1903, pp.6).

Kjo hartë përbën një vepër të qenësishme monumentale me vlerë të pamohueshme shkencore e cila doli në dritë në vazhden e projekteve të shumta atdhedashëse që sendërtuan figura të spikatura të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Harta e Shqipërisë me toponimastikë në shqip e 1902-shit krahas së qeni një vepër me rëndësi të shumëfishtë, nxjerr në pah edhe rrekjet e dyshes Aladro-Konica për të çuar përpara një nga pikat më kryesore të çështjes shqiptare që ishte përlindja intelektua-lo-kulturore e popullit shqiptar (Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë [më tej A.Q.Sh.], Fondi [më tej F.] 35, Viti [më tej V.] 1902, Dosja [më tej D.] 143, fletë [më tej fl.] 1).²

2 Sipas një proklamate të shpallur nga Don Gjin Aladro Kastrioti në janar të 1902-shit, mes të tjerash ai nënvizon rëndësinë që duhet t'u kushtohet shkollave shqipe nga veprimtarët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ndërsa për Faik Konicën zhvillimi i kulturës dhe i lëvrimin të gjuhës amtare shqipe përbënin pikat kryesore të botëkuptimit të vet si rilindës, pse ato sipas tij do t'i jepnin hov Rilindjes Kombëtare. Shih Kastrati, 2022: 126-127.




Figura 1.

Bashkëpunimi i begatë Aladro-Konica, 1901-1902

Bashkëpunimi midis Gjin Aladro Kastriotit dhe Faik Konicës zë fill në mesqershoren e 1901-shit, kur ky i fundit viziton spanjollin në Paris (Andrea, 2020: 484-486). Ai ishte vendosur në këtë qytet me daljen në pension nga karriera e tij e gjatë si diplomat në shërbimin e jashtëm të

Mbretërisë së Spanjës (Fernoel, 1903: 101). Don Aladroja ishte futur me të dyja këmbët në çështjen shqiptare më 1899 kur në kryeqytetin francez i mbiquajturi Komiteti Shqiptar i Parisit e shpall atë në mënyrë të habitshme prijëtar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ky komitet, që subvencionohej nga spanjoli, ishte një nga shumë organizatat shqiptare që ndihmoheshin financiarisht prej tij (Ferrer, 1902: 1; Nikaj, 2016, pp.117-118).³ Meqenëse Don Aladroja zotëronte një pasuri tepër të madhe, ai vendosi të ndihmonte me të holla botimin e periodikëve a të veprave të ndryshme letrare në gjuhën shqipe dhe veprimtarë të zëshëm shqiptarë (Clayer, 2012, pp.381).

Midis bashkëpunimeve dhe marrëdhënieve të shumta, të lulëzuara që pati me shqiptarë të spikatur veçohet ai me Faik Konicën, edhe pse për një periudhë të shkurtër dy vjeçare, 1901-1902. Sipas historianit Kristo Frashëri, revista politiko-kulturore “Albania” që drejtonte Faik Konica në Bruksel në të njëzetat e tij, ishte “një monument i lëvizjes patriotike rilindëse”, që e bëri Konicën jashtë mase të njohur në qarqet shqiptare anembanë rruzullit, nga Amerika deri në Rumani (Jorgaqi, 2001 [Faik Konica: Vepra 5], pp.176).

Nisur nga cilësitë që gëzonte “Albania” në sytë e publikut intelektual-atdhetar shqiptar, Don Aladro vendos të krijojë lidhje me kryeredaktorin e saj Faik Konica për dy arsye. Së pari për ta shfrytëzuar revistën e tij si një mjet informimi ku të popullarizonte personin e vet si pretendues i fronit të një principate të ardhshme shqiptare edhe së dyti, që ishte më kryesorja, nga etja që kishte spanjoli për të ndihmuar çështjen shqiptare vetë (Österreichisches Staatsarchiv/Haus-, Hof- und Staatsarchiv, Politisches Archiv XIV 12-3-1, fl, pp.30-31).⁴

3 Në gazetën e cituar të qytetit të Herezit, nga rridhte Don Aladroja, njoftohet se pas vendosjes së tij në Paris një grup shqiptar e cakton atë si kryetar të Lëvizjes Kombëtare. Mbështetur në kujtimet e meshtarit Dom Ndoc Nikaj, i cili ishte një prej bashkëpunëtorëve më jetëgjatë të Don Aladros, mund të hamendësojmë se ky grup ishte “Komiteti Shqiptar i Parigjit” që mbështetej financiarisht prej Gjin Aladro Kastriotit.

4 Në një relacion të datës 22 prill 1902, ambasadori austro-hungarez në Romë, Marius Freiherr Pasetti-Angeli von Friedenburg, i përcjell ministrit të jashtëm austro-hungarez, baronit Agenor Maria Gołuchowski, një informacion të marrë nga arbëreshi i njohur, Manilio Bennici. Sipas dokumentit që po citojmë, deduktojmë se Bennici ishte një agjent austriak. Relacioni citon një deklaratë me shkrim të bërë nga pretenduesi spanjoll, Gjin Aladro Kastrioti, ku ai artikulon

Disa nga arritjet e shënjuara të dyshes Aladro-Konica ishin: 1) themelimi i “Çmimit Skanderbeg” prej 1 000 frangash që i jepej atij shkrimtari shqiptar i cili kontribuonte më tepër në përsosjen e gjuhës së shkruar shqipe, që u fitua nga meshtari shkodran Dom Ndoc Nikaj (Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, Fondi: Arkivi i Vjenës: 1902-1907, fl, pp69-70); 2) identifikimi i shqiptarëve të rinj atdhedashës të cilët asokohe kishin nevojë për mbështetje financiare për veprimtaritë e tyre në shërbim të vendit, njëri syresh ishte edhe piktori rilindës Theohar Gjini, që Konica i rekomandoi të trokiste në derën e Don Aladros për ndonjë ndihmë (Hudhri, 2000, pp.155-162; A.Q.Sh., F. 13, V. 1902, D. 3, fl, pp.3-4)⁵ dhe për fund, 3) botimi i të parës hartë të trevave shqiptare me toponimastikë në shqip, që shënjoi zenitin, e po ashtu edhe mbylljen politikisht të detyruar të marrëdhënies së tyre. Te kjo e fundit do të ndalemi shkurtimisht në fund të artikullit.

Rrugëtimi i botimit të hartës së parë të Shqipërisë me toponimastikë në shqip, 1898-1902

Për të njohur e për të kuptuar në mënyrë tërësore zhvillimin e idesë, të projektit dhe të finalizimit të botimit të kësaj vepre themelore hartografike shkruesi i këtyre radhëve ka shfrytëzuar dy burime kryesore historike: letërkëmbimin e rregullt të Faik bej Konicës me këshilltarin

motivin e tij për përfshirjen në çështjen shqiptare. Aty Don Aladro thotë se motivi i vërtetë i përfshirjes së tij në çështjen shqiptare nuk është përmbushja e aspiratës së tij monarkike më shumë sesa kontributi që mund të japë ai në përparimin e çështjes shqiptare. Në deklaratën që përmendet në relacion, Don Aladroja s'ndihej aq shumë si një pasardhës i Skënderbeut, për shkak se ai rridhte nga dinastia Kastrioti në degë femërore. Për fund, në këtë dokument të cituar në relacionin e ambasadorit Pasetti shkruhet se Don Aladroja “duke qenë i vetëdijshëm se kishte një pikë gjaku shqiptari në venat e tij, nuk kishte si të mos investonte mendjen dhe pasurinë e vet në çështjen shqiptare”.

- 5 Theohar Gjini njihet si një ndër piktorët më të spikatur të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ai mbithirej “Piktori Mëmëdhetar” për arsye se realizonte shumë piktura me figurën e Skënderbeut. Talenti i tij, i frymëzuar nga ndjenjat nacionaliste shqiptare të kohës, tërhoqi vëmendjen e mjaft patriotëve shqiptarë si Asdreni, Sotir Peci, Nikolla Naço, Faik Konica, e tjerë. Ky i fundit, në kohën kur Theohar Gjini kishte rënë në vështirësi financiare, i sugjeron në një letër të datës 29 janar 1902 që t'i shkruaj Don Aladros për t'i kërkuar para. Në fund të letrës Konica e këshillon: “Në do, shkruaj-i dhe vetë, Aladros, thuai se të holla duhen pakë, e vetëm për dy viet.” Mbështetur në veprat e mëvonshme pikturike të Theohar Gjini mund të deduktojmë se ai iu drejtua spanjollit për ndihmë, i cili si duket i dha një dorë. Kjo pasi veprat me të cilat Theohar Gjini u mor në 1902-shin ishin dy portrete të spanjollit ku ai pozonte me kostumin popullor shqiptar dhe në një tjetër pikturë mjaft ikonike për kohën shfaqej portreti i Don Aladros përballë atij të Skënderbeut.

e ministrit të jashtëm austro-hungarez, baronin Julius Zwiedinek dhe artikujt në revistën “*Albania*” (1908-1902) që lidhen me hartën në fjalë. Qëmtimi i burimit të dytë dokumentar na ndihmon të zbardhim se çështja e të mbiquajturës “karte dheshkrimtare” (emërtim i mbështetur në përkthimin literal që Konica i bën “hartës gjeografike” nga frëngjishtja) daton shumë më herët sesa vetë bashkëpunimi Aladro-Konica (Vaugelas, 1902, pp.93).

Shtytja e Faik Konicës për realizimin e pastaj botimin e një harte të Shqipërisë në gjuhën shqipe, është e gërshetuar me një prej çështjeve kryesore që artikuloi në revistën e tij “*Albania*”, dhe kjo ishte njësimi i gjuhës shqipe, edhe për qëllime hartografike. Dijetari riosh Konica mori ngasje jo vetëm nga nevoja për botimin e një harte të Shqipërisë në shqip, por edhe që gjuha shqipe me të cilën do të shkruheshin njësitë fiziko-gjeografike të territoreve shqipfolëse të ishte një shqipe që të përbashkonte dy dialektet e mëdha të shqipes, gegërishten e toskërishten. Në një artikull të revistës “*Albania*” më 1898, ai nxjerr disa vërenjte të përpikta gjuhësore mbi njësimin e emrave të qyteteve shqiptare, prej këtu mund të deduktojmë zanafillën e projekt-idesë së një harte në gjuhën amtare të Konicës, tejet të vlefshme për fushën e albanologjisë edhe të hartografisë shqiptare. Në këtë artikull ai shkruan se në librat dhe në hartat që trajtojnë Shqipërinë emrat e qyteteve të gjinisë mashkullore si Berati apo Prizreni dalin në trajtën e tyre të pashquar (domethënë Berat dhe Prizren), ndërsa emrat e gjinisë femërore të qyteteve si Gjakova apo Janina jepen me trajtë të shquar. Faik Konica hedh idenë se për të shmangur gabimin e mësipërm emrat duhen shkruar kështu, pra sipas rastit në shqyrtim: Gjakovë dhe Janinë. Një rregull ky që ndiqet me përpikmëri nga hartografët shqiptarë edhe sot e kësaj dite (Konica, 1898, pp.100).

Njoftimi i parë për hartën në shtypin shqiptar të kohës lajmërohet nga “*Albania*” koniciane në shtator të 1900-s. Në artikullin me titull “*KARTA E SHCIPERISE*”, Faik Konica vë në dijeni lexuesit e tij se projekti i vet hartografik është gati, vetëm se i mungon financimi për ta botuar. Ndër

të tjera erudit i ri shqiptar pohon se ai e kishte diskutuar këtë çështje me drejtuesin e Institutit të Gjeografisë të Brukselit, Elisée Reclus (1830-1905) (Konica, 1900, pp.6-7). Ky gjeograf i shquar me prejardhje nga Franca ishte autor i një vepre monumentale gjeografike të titulluar “Gjeografia e Re Universale”, e cila doli në 19 vëllime dhe i kishte kushtuar Reclus-it plot 18 vite punë (1876-1894) (John Clark ve Camille Martin, 2013, pp.8, 15).

Reclus i dha Konicës një preventivë fillestare prej 1 800 frangash, që më vonë e zbret bujarisht në 1 500 franga, për një tirazh me 1 500 kopje të hartës. Sakaq, lajmërimi për projektin e kësaj harte mbyllet me thirrjen e Konicës që lexuesit e revistës së tij të kontribuonin monetarisht në botimin e kësaj vepre të rëndësishme, pasi, siç shkruan ai në artikull: “*Ky chenim eshte faré i pake, sé karta nuke do te jeté ñe lodre, po mé ñe te vertete vlére shkentsetaré...*” (Konica, 1900: 7; Konica, 1905, pp.73-74).

Në këtë moment rishfaqet Don Gjini Aladro Kastrioti, i cili tregohet plotësisht i gatshëm që të mbulonte shpenzimet e hartës. Më herët, këtë barrë kishte vendosur ta merrte përsipër shoqëria “Bashkimi” në Shkodër, nëpërmjet mbledhjes së fondeve (Andrea, 2020: 497; Jorgaqi, 2001 [Faik Konica: Vepra 4], pp.96-97).⁶

Pasi u siguruan të hollat për hartën, Reclus ngre një ekip pune për përpilimin e saj të përbërë nga dy hartografë të Institutit që drejtonte, zotërinjtë Bertrand dhe Patteson (Konica, 1902, pp.113-114).⁷ Mirëpo, studiuesi i Faik Konicës, Fotaq Andrea, hedh tezën se edhe vetë Faiku ishte pjesë e këtij grupi pune. Studiuesi Andrea jep argumente shteruese shkencore të cilat e bëjnë lexuesin ta mbështesë tezën e sipërthënë. Dy argumentet e tij më kryesore janë: erudicioni i gjerë i Konicës dhe ideja origjinale e tij për botimin e një harte të trevave shqipfolëse në gjuhën amtare (Andrea, 2016, pp.95).

6 Sipas një letre të datës 29 nëntor 1901 që Konica i dërgon Visarion Dodanit, i cili asokohe ishte një veprimtar i angazhuar shqiptar në koloninë e Bukureshtit, thuhet se Don Aladroja i kishte dhënë tashmë të hollat për hartën e Shqipërisë që pritej të botohej së shpejti. Në letër thuhet: “Princi i Aladros dha edhe disa mijëra frënga për një kartë dheshkrimtare të Shqipërisë që do të dalë në dritë në funt të Kalëndorit”.

7 Konica nuk i jep të plotë emrat e hartografëve-ndihmës të Reclus-it që ndihmuan në realizimin e hartës.

Dy hartat referenciale që grupi i punës në Bruksel shfrytëzon për ndërtimin e hartës së tyre unikalë ishin dy botime të Hartës së Shqipërisë të Institutit Gjeografik Ushtarak të Vjenës, njëra e vitit 1880 dhe tjera e vitit 1900 (Ibid, pp.99-100).

Në numrin e 4-t të revistës “*Albania*” për vitin 1902, Faik Konica shpall me galdim se kishte dalë nga shtypi “E para karte e dheut t’one...”. Lajmërimi i Konicës mbyllet me një falënderim të ngrohtë në drejtim të Gjin Aladro Kastriotit, i cili përmes filantropizmit të tij kishte mundësuar botimin e këtij projekti kaq të vlefshëm për kulturën edhe shkencën shqiptare. Konica aty shkruan:

“Do t’ishim ne faj ne mos i faleshim Z. T. Don Ghinit t’Aladros per ndihmen ce na dha me ne shpejtim, me ne ndzehtesie ce s’mundim t’a harojme. Me te holla te tij u-mbarua kio pune, e, ne mos per tiater ghe, te paken *kete miresie* (shkrimi me italik i Faik Konicës - shënim i Xherardo Nikjarit) ch’do atdhetar duhet te i a njohe” (Konica, 1902, pp.104-105).

Harta i mbërriti edhe baronit Zwiedenik (Andrea, 2020, pp.573).⁸ Rrjedhimisht, popullariteti që fitoi harta në radhët e intelektualëve shqiptarë ishte i gjerë dhe kopjet e saj mbaruan në gusht të 1912-s. Kjo e dhënë na bën të hamendësojmë se shumëfishimi i hartës me toponimastikë në shqip njohu disa tirazhe gjatë harkut të 10 vjetëve (1902-1912) për të përmbushur kësodore kërkesat e blerësve të ndryshëm (Jorgaqi, 2001 [Faik Konica: Vepra 4], pp.176).

Disa të dhëna të pëgjithshme përshkrimore të hartës së Shqipërisë me toponimastikë në shqip të vitit 1902

Shqyrtimi i parë i kësaj harte është bërë nga studiuesi Fotaq Andrea, në artikullin e tij, “Tjetër zbulim i rallë nga miniera Konica/Harta e tij shqiptare e vitit 1902” (Andrea, 201, pp. 92-102). Pasi e zbulon këtë hartë në Bibliotekën Kombëtare në Belgjikë, Bruksel, konicologu Andrea e hulumton thellë këtë hartë dhe arrin një studim serioz mbi të. Punimi i tij studimor mbi hartën “koniciane”, sikurse e quan ai këtë vepër hartografike, merret kryesisht me dy tema ku autori ka qenë jo i mangët:

8 Përmes një letre të datës 21 korrik 1902 Faik Konica i shkruan baronit Zwiedinek se i ka dërguar 12 ekzemplarë të hartës së Shqipërisë.

1) historikun e përpunimit të hartës, duke filluar qysh nga hulumtimet e para të Konicës për një hartë të Shqipërisë në gjuhën shqipe e deri tek botimi i saj më 1902;

2) dhe parashtrimin e argumenteve shkencore mbi bashkautorësinë e Faik Konicës si një nga realizuesit e kësaj harte, duke e ndërthurur njëherazi edhe me vizionin rilindës që Konica kishte për dobritë e mëdha që do të sillte botimi i një vepre të tillë hartografike.

Të dyja këto tema përpunohen më së miri edhe me shtjellimin që Fotaq Andrea i bën kontekstit historik të momentit kur harta e Shqipërisë sheh dritën e botimit më 1902. Thënë kjo, këtij punimi studimor pioner mbi hartën e 1902-shit i ka munguar deri më tani një përshkrim i hollësishëm, i bashkërenditur të elementëve fiziko-gjeografikë, topografikë, edhe hartografikë.

Deri më tani janë identifikuar dy ekzemplarë të kësaj harte kaq unikalë. Njëri ekzemplar është zbuluar nga studiuesi Fotaq Andrea në Bibliotekën Kombëtare të Belgjikës në Bruksel (Institut géographique de l'Université nouvelle de Bruxelles. "Shcypenia = Shciperia" Hartë, 1902. Bibliothèque royale de Belgique), ndërsa një ekzemplar i dytë ndodhet në Fondin Albanologjik të Bibliotekës Publike "Marin Barleti" në Shkodër (Institut géographique de l'Université nouvelle de Bruxelles. "Shcypenia = Shciperia" Hartë, 1902. Biblioteka Publike "Marin Barleti", Fondi Albanologjik). Duhet të nënvizojmë se këto dy ekzemplarë janë identikë në përmbajtje, veçse ekzemplari në Shkodër (që ka gjasë të mos jetë hartë e tirazhit të parë) nuk e ka dedikimin në adresë të Don Aladros ku falënderohet për bujarinë e tij financiare në botimin e hartës. Shkruesi i këtyre radhëve do të ndalet mëposhtë në arsyen e këtij ndryshimi të bërë.

Në përshkrimin e hartës së parë me toponimastikë në shqip do ta bëjmë duke u mbështetur tek ekzemplari që ndodhet në Bruksel. Të dhënat e përgjithshme mund t'i rendisim si vijon:

Së pari, harta e vitit 1902, që ishte fryt i bashkëpunimit Aladro-Konica është një paraqitje e përgjithshme e relievit fizik të shtrirjes gjeografike të trungut etnik shqiptar që hapej në katër vilajetet osmane të Ballkanit Perëndimor. *Së dyti*, veçoria kryesore që e bën këtë hartë kaq të jashtëzakonshme në raport

me hartat e tjera për trevat shqiptare që qarkullonin deri në atëkohë ishte përdorimi i gjuhës shqipe në toponimastikë. Konica në cilësinë e nismëtarit të hartës së parë me toponimastikë në shqip vendosi të shfrytëzonte variantin e alfabetit të shqipes me germa latine që përdorte tek “*Albania*” për hartën në fjalë. Edhe pse standardizimi i alfabetit të shqipes me bazë atë latin ndodhi në Kongresin e Manastirit më 1908 (Grup autorësh, 2007, pp. 391-393), në asokohë ky variant ishte tej mase i përhapur në qarqet intelektuale-patriotike shqiptare që merreshin me botime periodikësh, sidomos pas rrëzimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Gjithashtu, alfabeti me të cilën u hodhën në hartë emrat e njësive të ndryshme gjeografike, krahas germave latine, përbëhej nga ato që mbiquheshin germa dyshe, që tregonin tinguj të veçantë të shqipes (Hoxha, 1986, pp.178-181). *Së treti*, në krye të hartës shpaloset titulli i saj, Shqipëria-Shqypnia, në dy kryedialektet e shqipes i shkruarë në një të vetëm. *Së katërti*, harta e vitit 1902 gëzon përmasat 1.2 x 0.75 metra, në shkallën 000 1:500. *Së pesti*, poshtë titullit shpaloset me germa të mëdha mirënjohja e tepruar ndaj Don Gjini Aladro Kastriotit: “*E’ para karte é dheut t’one é shtypur/n mé të holla të Lartesisë Tij Don Ghinit, Marcés i Aladros é prints i Kastrioteve nga ghaku i te Madhit t’one Skenderbég, Pérendia i faltë jéte te ghate*” (Figura 2).



Figura 2.

Së gjashti, në një të dhënë tjetër të kësaj harte përfaqet përpjekja madhore e Konicës për të përshtatur në shqip termat e huaj shkencorë. Në vend të terminologjisë së sotme shkencore “hartë gjeografike”, Konica përdor fjalën “karte dhe-shkrimtare”, jo vetëm për arsye të frankofilizmit të tij, por edhe sepse donte të shmangte orientalizmat si në rastin konkret, ku fjala “hartë” rrjedh nga turqishtja “*harita*”. Po kështu, nëse vëmë re poshtë hartës, në të majtë të saj, jashtë kornizës së vet, tregohet në frëngjisht dhe shqip botuesi edhe viti i botimit: *Université Nouvelle. Institut Géographique de Bruxelles (1902)* dhe *Ghithemsim i Ri. Institut Dhëshkrimtar i Bruselit (1902)*. Po kështu, *së shtati*, vëmë re edhe një orvatje tjetër të Konicës në këtë drejtim që është neologjizma që përdor

për dy miniharta që i pagëzon me emrin “kartica” (Figura 3), nga frëngjishtja “*cartouches*” (Konica, 1902, pp.105). “Karticat” përmbajnë dy harta që dëftojnë të njëjtën shtrirje gjeografike të trevave etnike shqiptare sikurse harta me toponimastikë në shqip, por këto dy harta gëzojnë tipologji të ndryshme, njëra ka karakter gjeologjik dhe tjetra klimatik. Rëndësia e këtyre “karticave” është e paçmueshme pasi që ato përbëjnë dy mrekulli të tjera pionere në llojin e tyre brendapërbrenda lëmit të hartografisë shqiptare. Miniharta gjeologjike është pasqyrimi i parë i depozitimeve të trevave shqiptare. Ajo është më e hershme sesa harta gjeologjike e veriut të Shqipërisë e baronit austro-hungarez Franz Nopcsa, botuar në veprën “*Geographie und Geologie Nordalbanians*” më 1929 (Pango ve Kosta, 2014, pp.220), që është mbajtur deri më tani si harta e parë gjeologjike shqiptare. Mirëpo, miniharta gjeologjike e vitit 1902 është e thjeshtë dhe ndonëse i mungon karakteri i mirëfilltë shkencor, ajo ka vlerë vetëm historike. Për sa i përket hartës klimatike, veçantitë që e përshkojnë atë janë më eprorë. Miniharta klimatike nuk është vetëm e para hartë klimatike e trevave shqiptare, pa marrë parasysh gjuhën e përdorur në të, por përbën një risi tejet moderne edhe për hartografinë botërore. Kjo minihartë është botuar 2 vite pas botimit të hartës së parë të mirëfilltë klimatike në botë nga gjeografi Wladimir Köppen, më 1900 (Conrad, 1941, pp.154). Shenjat e saj konvencionale tregojnë izohietet dhe izotermet që paraqesin vlerat e përvitshme të rreshjve në hapësira të caktura gjeografike të trevave shqiptare.




Figura 3.

Së teti, harta e parë me toponimastikë në shqip e vitit 1902 nuk është një hartë politike, por fizike, e cila na jep një paraqitje të kënaqshme të njësive gjeografike të viseve shqipfolëse në krahun perëndimor të zotëri-meve evropiane të Perandorisë Osmane. Ndonëse harta nuk ka kufij politikë, Konica dhe gjeografët e tjerë belgë që u morën me përpunimin e hartës u kujdesën që të vendosin me germa të mëdha shtetet me të cilat kufizoheshin trevat shqiptare asokohe: Perandoria Austro-Hungareze në veri dhe veri-perëndim, Mali i Zi në veri, Serbia në veri dhe veri-lindje edhe Greqia në jug. *Së nënti*, toponimet në shqip të njësive gjeografike në hartë arrijnë numrin 400, ku futen këtu qytete, fshatra, male, lumenj, liqene, dete dhe fusha. *Së dhjeti*, legjenda e hartës përmban shenjat konvencionale të 5 nivelimeve të lartësive të relievit nga 0 - 2 000 metër e sipër, por nuk përmban një shenjë konvencionale për të treguar shkallën e thellësisë së deteve apo të liqeneve, gjë e cila në rastin

e liqenit më të thellë të Shqipërisë, atij të Ohrit, me prejardhje tektonike, do të ishte një veçori thelbësore gjeografike për t'u shënuar. *Së njëmbëlljeti*, nisur nga këqyrje të tjera vëmë re se harta ka të ndërthuar bashkazi me elementët gjeografikë, fizikë dhe hartografikë edhe elementë etnografikë. Mbështetur në toponimet në gjuhën shqipe që shpalosen në këtë hartë, mund të deduktojmë shtrirjen e qyteteve a të fshatrave me shumicë shqiptare sipas studimeve të rrahura nga Faik Konica në Ballkanin perëndimor, për fillimshkullin XX, nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim. Toponimi më skajor verior që Konica vë në hartë është qyteza e Bellopojës, që shtrihej në rajonin e Sanxhakut, kurse toponomi më skajor në jug të viseve shqiptare shënjohej Vonica (*Vonitse* - sipas hartës) në bregun jugor të Gjirit të Artës në Greqinë e sotme. Është interesante të nënvizojmë se për Faik Konicën rajoni i Çamërisë ishte territori i fundit me element etnik shqiptar në drejtim jugor. Çamëria kufizohet në jug me rrjedhën e poshtme të lumit të Artës dhe pas një këqyrje të thjeshtë vëmë re se thujtja e gjithë hapësira në cepin e poshtëm, në të djathtë të kornizës së hartës, është memece në aspektin toponimastik. Përveçse vihen në dukje vargmalet e Pindit, në lindje të rajonit të Çamërisë. Po ashtu, një hapësirë gjeografike memece është hapësira gjeografike veri-perëndimore në cepin e majtë të hartës, lart, që përkon me territoret e shtetit të sotëm të Bosnje-Hercegovinës që asokohe ishin në protektoratin e Austro-Hungarisë dhe mandej më 1908 do të aneksoheshin prej saj (Grup autorësh, 2007, pp.397). Pika më skajore e hartës në perëndim përkon me kryeqytetin e Malit të Zi, Cetinjen (*Tsetine* - sipas hartës), i cili shquhej për një komunitet të konsoliduar shqiptar. Ndërsa në lindje, shtrirja e trevave me shumicë etnike shqiptare përfundonte në Kriva Palanka (*Pallange* - sipas hartës) të Maqedonisë së sotme të Veriut.

Së fundi, harta e 1902-shit na jep edhe disa të dhëna të bollshme rreth përhapjes gjeografike të kënetave, një pjesë e konsiderueshme e të cilave u bonifikuan në dy periudha të ndryshe historike të Shqipërisë. Periudha e para e bonifikimit të shumicës së kënetave që shpalosen në hartë, kryesisht kënetat përgjatë Ultësirës Perëndimore, ndodhi në gjysmën e

dytë të viteve '20 të shekullit XX. Kjo periudhë përkon me ngritjen e një sistemi të gjerë kanalizimi dhe irrigacioni me qëllim zgjerimin e tokave të punueshme dhe përmirësimin e kushteve të punës së bujkut në këto territore, sot ish-kënetë (Zavalani, 1998, pp.296). Periudha e fundit e përtharjes së gjerë të hapësirave të mëdha gjeografike kënetore zë vend në vitet e para të ngritjes së diktaturës komuniste në Shqipëri, më 1946. Tipikisht bëhet fjalë për tharjen e kënetës së Maliqit në jug-lindje të vendit, e cila në hartën e Shqipërisë së vitit 1902 na prezantohet me emërtimin toponimastik “Liçeni i Maliqit”, duke parakuptuar kësisoj sipërfaqen e gjerë gjeografike të kënetës në ato vite (Ndoja, 2017, pp.7-8).

* * *

Bashkëpunimi Aladro-Konica u ndërpre si pasojë e lidhjeve të dendura të spanjollit me arbëreshët. Faiku vetë, si proaustriak, në këmbim të pranimit të ndihmës nga ana e Don Aladros i kishte vënë kusht spanjollit që të mos ngatërrohej me grupet italo-shqiptare që përfaqësonin tërthorazi interesat e Italisë në Shqipëri (Andrea, 2020: 533; Kocaqi, 2020, pp.36). Meqenëse Konica dhe mjaft bashkëpatriotë të tij ishin rreshtuar kraher interesave austro-hungareze (që rivalizonin ato të Italisë) në rajon, ata i kundërshtonin herë haptazi, herë larg e larg synimet italiane për hesap të Monarkisë së Danubit (Jorgaqi, 2001 [Faik Konica: Vepra 4], pp.140-141). E për këtë arsye në një nga tirazhet e hartës, Konica vendosi t'i hiqte shkrimin mirënjohës dedikuar Don Gjini Aladro Kastriotit. Ky ekzemplar ndodhet në Bibliotekën Publike të Shkodrës “Marin Barleti” (Figura 4).



Figura 4.

Për sa i përket Don Aladros, angazhimi i tij me disa qarqe italo-shqiptare u lexua gabimisht nga Austro-Hungaria si një pozicionim i prerë i spanjollit nga ana e Italisë. Sikur e kemi thënë mësipër qëllimi i tij ishte financimi i çfarëdolloj grupi që propagandonte të drejtat e shqiptarëve, dhe këtu nuk bënin përjashtim as grupet italo-shqiptare. Sidoqoftë, bashkëpunimi i shkurtër Aladro-Konica për aq sa zgjati pati rezultate të jashtëzakonshme në dobi të çështjes shqiptare. Ato arritën valencën më të lartë me botimin e hartës së parë me toponimastikë në shqip më 1902.

Përfundim

Në përfundim mund të pohojmë me pa mëdyshje se me këtë hartë themelohet fusha e hartografisë shqiptare. Ajo përmban elemente tejet moderne brenda kontekstit të hartografisë bashkëkohore të kapërcyellit të shekullit XX. Ky përfundim lidhet kryesisht me faktin se përpunimi i saj u realizua nga një prej mendjeve më të mëdha të gjeografisë botërore siç ishte gjeografi i famshëm Elisee Reclus, që përdori teknikat më të përparuara hartografike të kohës.

Gjithashtu nëpërmjet kësaj vepre themeltare për kulturën edhe shkencën shqiptare deduktojmë të dhëna të rëndësishme për dy aktorët kryesorë që e realizuan, Don Aladro Kastrioti dhe Faik Konica. Harta e 1902-shit na bën të kuptojmë përkushtimin e Don Aladros ndaj çështjes shqiptare, nëpërmjet financimit të projekteve që ishin në shërbim të kulturës dhe propagandës shqiptare. Ndërsa Konica përmes kontributit që dha në ndërtimin e hartës së parë shqipe del në pah edhe si gjeograf, edhe si hartograf. Dy attribute këto që i shtohen figurës së tij shumëplanëshe rilindëse për shkak të attributeve të tija si historian, sociolog, letrar, shkimentar, poet, përkthyes, kritik, diplomat e tjerë.

Për fund, mund të pohojmë se harta e Shqipërisë e vitit 1902 ndonëse ka lajthitje a pasaktësi jo të pakta gjeografike, ajo prapëseprapë bart vlera albanologjike, historike, gjuhësore dhe pa dyshim, shkencore.

Aspects of the First Map of Albania With Toponymy in the Albanian Language (1902)

Xherardo Nikjari

Throughout history, numerous maps and atlases have been produced by cartographers, historians, and institutions from various European nations and beyond, depicting the spatial distribution of Albanians and Albania. Despite their significant cartographic and historical value, showcasing the ancient ethnicity of Albanians in the Balkans, these maps were invariably created in the languages of foreign cartographers rather than in Albanian. The 1902 publication of the first map of Albanian territories using Albanian toponymy marks a pivotal historical moment, establishing the foundation of Albanian cartography. This study delves into the historical, geographical, linguistic, and cultural



MA, Independent researcher, Tirana-Albania, xherardonikjari@gmail.com



<https://orcid.org/0009-0001-1275-4665>



Balkan Studies Foundation
DOI: <http://doi.org/10.51331/A045>
Journal of Balkan Studies, 4 (2), 2024
balkanjournal.org



Received: 04.05.2024
Revision: 31.05.2024
Accepted: 01.07.2024



significance of this notable achievement, which was a product of a fruitful collaboration during the Albanian National Awakening between Don Juan Pedro de Aladro Kastrioti (known to Albanians as Gjin Aladro Kastrioti) and Faik bey Konica, the founder and editor of the Albanian National Awakening magazine “Albania.”

Aladro Kastrioti, a former brilliant diplomat who became involved in the Albanian question during the XIX and XX centuries, claimed descent from the Albanian national hero of the XV century, Gjergj Kastrioti-Skanderbeg, and aspired to the throne of Albania. In his efforts to raise national awareness among Albanians, he financed various cultural projects, one of which was the cartographic project that led to the creation of the 1902 map. This collaboration resulted in the creation of a significant cultural and historical artifact that not only represented a technical achievement in mapping but also served as a symbolic assertion of Albanian identity and territorial aspirations.

The paper examines the cartographic and geographical characteristics of the first map of Albania with Albanian toponymy from 1902. It is the first paper to scientifically explore the journey leading to the publication of this map and attempts to explain its characteristics in geographical, linguistic, and historical terms. Noteworthy among the descriptive data of this cartographic work is the extent of the ethnic Albanian presence in the Western Balkans during the early 1900s. The map reflects a detailed understanding of the ethnic distribution of Albanians, emphasizing their historical and cultural presence in the region.

The creation of this map was not an isolated endeavor but part of a broader movement of national and cultural renewal among Albanians. The Albanian National Awakening (Rilindja Kombëtare) was a period marked by efforts to revive and promote Albanian culture, language, and national identity. The collaboration between Aladro Kastrioti and Faik Konica symbolizes the intersection of these efforts with European intellectual and political currents. Faik Konica, a prominent Albanian intellectual and nationalist, played a crucial role in shaping the cultural

and political discourse of the time. His work in publishing and promoting Albanian literature and history was instrumental in fostering a sense of national identity among Albanians.

Additionally, this paper will detail the invaluable assistance provided by *Élisée Reclus*, one of the foremost geographers of the time, in guiding the working group involved in constructing the first map of Albania with Albanian toponymy. *Élisée Reclus* was a renowned French geographer whose contributions to the field of geography and cartography were significant. His involvement in the project added a layer of scientific rigor and credibility, ensuring that the map was not only a cultural artifact but also a reliable geographical document.

The map's publication in 1902 was a strategic move in the context of the broader political and cultural objectives of the Albanian national movement. It was designed to assert the historical and territorial aspirations of Albanians at a time when the Balkan region was undergoing significant political changes. The map served as a visual representation of Albanian claims to their homeland, challenging the narratives and maps produced by neighboring nations and foreign powers.

One of the rare features of this map is the inclusion of two minimaps, which are annexed inside the main map. The first minimap is a geological map of Albania, the first of its kind. This geological map provided valuable information about the natural resources and geological features of the region, which were of significant interest not only for scientific purposes but also for economic and strategic reasons. The inclusion of these minimaps reflects the interdisciplinary approach of the project, combining elements of geography, geology, and climatology to present a holistic view of Albania.

The second minimap is a climatic map of Albania, which was highly innovative for the cartographic field at the time. The concept of climatic mapping was relatively new, with the first climatic map in the world being published just two years earlier by the prominent German-Russian geographer *Wladimir Köppen*. This inclusion highlights the advanced

scientific approach taken by the creators of the map and their intention to provide a comprehensive understanding of the Albanian territories.

The collaboration between Aladro Kastrioti, Faik Konica, and Élisée Reclus in the creation of this map underscores the transnational and interdisciplinary nature of the project. It involved contributions from individuals with diverse backgrounds and expertise, reflecting the interconnectedness of European intellectual and political networks at the time. The map stands as a testament to the power of collaboration and the exchange of ideas across borders.

The descriptions of this map in this paper are based on two primary sources: the original copy of the map held in the Royal Library of Belgium and another copy in optimal condition located at the Public Library “Marin Barleti” in Shkodër, Albania. These copies provided a comprehensive basis for examining the cartographic details and the broader historical and cultural context of the map.

In analyzing the map, this paper also considers the technical and artistic aspects of its creation. The mapmakers employed advanced cartographic techniques for their time, ensuring accuracy and clarity in depicting the Albanian territories. The choice of toponymy was particularly significant, as it involved the standardization of Albanian place names, which were often distorted or replaced by foreign versions in other maps. This act of naming was a reclaiming of space and identity, asserting the Albanian connection to their land.

Moreover, the publication of the map was not merely an academic exercise but had practical implications for the Albanian national movement. It served as a tool for political advocacy, providing a visual representation of Albanian territorial claims that could be used in diplomatic negotiations and public campaigns. The map was likely intended to influence both domestic and international audiences, rallying support for the Albanian cause and countering the narratives of other Balkan nations.

This interdisciplinary approach, combining geography, geology, and climatology, reflects the comprehensive vision of the map's creators. They aimed to produce a document that was not only politically significant but also scientifically valuable. The involvement of *Élisée Reclus*, a prominent geographer, ensured that the map adhered to the highest standards of scientific accuracy and cartographic excellence. His guidance was instrumental in shaping the map's content and methodology, integrating the latest geographical knowledge and techniques.

The impact of this map extended beyond its immediate political and cultural context. It laid the groundwork for future cartographic and geographical studies of Albania and the Balkans. Subsequent maps and studies built upon the foundations established by this pioneering work, further advancing the field of Albanian cartography and contributing to the broader understanding of the region's geography and history.

Furthermore, for Albanians, asserting their presence on the map was not merely an academic exercise but a crucial step in the broader fight for recognition and independence. The map was a declaration of existence and a statement against the erasure and marginalization of Albanian identity.

In conclusion, the publication of the first map of Albanian territories with Albanian toponymy in 1902 represents a significant milestone in the history of Albanian cartography and the Albanian National Awakening. This paper explores the historical, geographical, linguistic, and cultural significance of this achievement, highlighting the collaborative efforts that made it possible. The involvement of figures like *Aladro Kastrioti*, *Faik Konica*, and *Élisée Reclus* demonstrates the transnational and interdisciplinary nature of the project, which combined scientific rigor with cultural and political aspirations. The map not only served as a valuable geographical document but also as a powerful symbol of Albanian identity, influencing the course of the Albanian national movement and contributing to the broader understanding of the region's history and geography.

Bibliografia

Burime arkivore dhe biblioteka:

- Arkivi i Muzeut Historik Shkodër*, Fondi: Arkivi i Vjenës: 1902-1907, fl. 69-70.
- Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej A.Q.Sh.), Fondi (më tej F.) 35, Viti (më tej V.) 1902, Dosja (më tej D.) 143, fletë (më tej fl.) 1.
- A.Q.Sh., F. 13, V. 1902, D. 3, fl. 3-4.
- Österreichisches Staatsarchiv/Haus-, Hof- und Staatsarchiv, Politisches Archiv XIV 12-3-1, fl. 30-31.
- Institut géographique de l'Université nouvelle de Bruxelles. "Shcypenia = Shciperia" Hartë, 1902. Biblioteka Publike "Marin Barleti", Fondi Albanologjik.
- Institut géographique de l'Université nouvelle de Bruxelles. "Shcypenia = Shciperia" Hartë, 1902. Bibliothèque royale de Belgique.

Revista dhe periodikë:

- Conrad, V. (1941). Obituary: Wladimir Köppen. *Geographical Review*, Vol. 31 (1), 154-155.
- Fernoel (1903). Don Juan de Aladro Kastrioti: Prince d'Albanie. *L'Echo des Jeunes*, 1 tetor 1903, 100-101.
- Ferrer A. J. (1902). D. Juan P. de Aladro y Kastriota: Principe de Albania. *El Guadalete*, 25 maj 1902, 1.
- Lopez, R. J. (2002). El Jerezano Juan Pedro Aladro Kastriota: Principe de Albania. *Revista de Historia de Jerez*, 8, pp.207-218.
- Konica, F. (1898). Notes Diverses. *Albania*, 2 (6), 100.
- Konica, F. (1900). Karta e Shciperise. *Albania*, 4 (5), pp. 6-7.
- Konica, F. (1902). Karta dheshkrimtare. *Albania*, 6 (4), pp.104-105.
- Konica, F. (1902). La première carte d'Albanie. *Albania*, 6 (4), pp.113-114.
- Konica, F. (1905). Fleta e Drectorit. *Albania*, 9 (4), pp.73-74.
- Konica, F. (1907). Fleta e Drectorit. *Albania*, 11 (4), pp.73-76.
- Vaugelas (pseudonim i Faik Konicës). (1902). Karte-Harte, *Albania*, 6 (4), pp.93-94.
- Andrea, F. (2016). *Faik Konica - Përlindësi Modern*. Tiranë: Zenit Editions.
- Andrea, F. (Ed.), (2020). *Letërkëmbim 1897-1912, "Albania" dhe Vjena*. Prishtinë: Botime Artini.
- Clark J. ve Martin C. (Ed.). (2013). *Anarchy, Geography, Modernity: Selected Writings of Elisee Reclus* (trans. John Clark ve Camille Martin). Michigan: PM Press.
- Clayer, N. (2012), *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar* (trans. Artan Puto), Tiranë: Botimet Përpjekja. (Viti origjinal i botimit, 2007).

- Grup autorësh (2007). *Historia e Popullit Shqiptar II: Rilindja Kombëtare*, vitet 30 të shek. XIX-1912. Tiranë: Botimet Toena.
- Hoxha, D. I. (1986). *Nëpër udhën e penës shqiptare*. Tiranë: Shtypshkronja Mihal Duri.
- Hudhri, F. (2000). *Arti i Rilindjes Shqiptare*. Tiranë: Botimet Onufri.
- Jorgaqi, N. (Ed.). (2001). *Faik: Konica: Vepra 4*. Tiranë: Botimet Dudaj.
- Jorgaqi, N. (Ed.). (2001). *Faik: Konica: Vepra 5*. Tiranë: Botimet Dudaj.
- Ndoja, Leka (2017). *Gjyqi i Grupit Tekniko-Intelektual: Procesi i Maliqit, 1946*. Tiranë: ISKPK.
- Nikaj, D. N. (2016), *Kujtime të një jete së kalueme*. Tiranë: Botime Onufri.
- Kastrati, J. (2022). *Faik Konica: Monografi*. Tiranë: Shtypshkronja Kristalina-KH.
- Kocaqi, E. (2020). *Shqipëria dhe Fuqitë e Mëdha: 1878-1918*. Tiranë: Dodona Press.
- Pango, A. ve Kosta, S. (2014). *300 autorë të huaj për Shqipërinë*. Tiranë: Botime Maluka.
- Skëndi, S. (1967). *The Albanian National Awakening: 1878-1912*. Princeton: Princeton University Press.
- Zavalani, T. (1998). *Histori e Shqipnis*. Tiranë: Shtëpia e librit Phoenix.